

BASHKIA KORCE
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Date 22.09.2015

Nga: *Bashkia Korce, rruga "28 Nentori", 082 243353.*

Për: *Shoqeria "Konstruksion - 93" sh.p.k , adresa: Korce,Rr.1 Maji,L.18 si perfaqesuese e bashkimit te operatoreve ekonomike "Konstruksion - 93" sh.p.k dhe "Xhengo" sh.p.k*

* * *

Procedura e prokurimit: *Procedure e hapur*

Objekti: *"Infrastruktura e brendshme e Qendres per ruajtjen dhe promovimin e kultures /Muzeu i Artit Mesjetar"*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *Kjo kontrate ka per qellim realizimin e infrastruktures te brendshme te Qendres per ruajtjen dhe promovimin e kultures /Muzeu i Artit Mesjetar"*

Fondi limit: *129.684.651 lek*

Burimi i financimit: *Buxheti i shtetit Investim*

Data e zhvillimit te procedures se prokurimit: *04.09.2015*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): *Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri] –*

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët x**

Njoftojme se, kane qene pjesemarres ne procedure keta ofertues me vlerat perkatese te ofruara:

**1.Shoqeria "KEVIN KONSTRUKSION"sh.p.k NIPT K71401004W me vlere:
108.443.650 (njqind e tete milion e katerqind e dyzet e tre mije e gjashteqind e pesedhjetel)lek**

**2.Bashkimi i operatoreve ekonomike, Shoqeria "BELADI" sh.p.k NIPTJ62903254C dhe Shoqeria "BEQARI" sh.p.k NIPT J64103603J me vlere:
114.123.305(njqind e katermbedhjetel milion e njqind e njezet e tre mije e treqind e pese)lek**

**3.Bashkimi i operatoreve ekonomike, Shoqeria KONSTRUKSION 93 sh.p.k NIPT J64103148B dhe Shoqeria "XHENGO"sh.p.k NIPT J64103171M me vlere:
126.121.246,9(njqind e njezet e gjashte milion e njqind e njezet e nje mije e dyqind e dyzet e gjashte presje nente) lek**

* * *

Jane s'kualifikuar ofertuesit e meposhtem:

1. Shoqeria "Kevin Konstruksion"sh.p.k NIPT K71401004W per arsye se:

1- Ka mangesi te theksuara ne dokumentacionin e kerkuar ne dokumentet e tenderit,kriteret e vecanta te kualifikimit ,kapaciteti teknik,pika 5.

Mangesite jane si me poshte:

-Lidhur me materialet "Pllaka", "Lesh guri" dhe "Vida" eshte paraqitur nje autorizim nga shoqeria "Saimiri -F" sh.p.k

Bashkelidhur me autorizimin jane paraqitur disa te dhena teknike .Dokumentacioni ku jane shenuar te dhenat teknike nuk eshte i firmosur dhe as kane longon e prodhuesit dhe si rezultat nuk vertetohet qe jane materiale qe prodhohen prej tij dhe per me teper nuk plotesohen kerkesat teknike te percaktuara ne specifikimet teknike per keto materiale.

Lidhur me materialin "Pllaka " nuk eshte paraqitur certifikata e bioarkitektures .

-Per produktin "dyer" eshte paraqitur nje dokument me emertimin "Skede teknike per dyer" e cila eshte ne gjuhe te huaj dhe nuk ka autorizim prodhuesi

-Per produktet "xham" dhe "Vetrata" nuk eshte paraqitur skeda teknike dhe autorizimi I prodhuesit

2. Duke qene se ne preventiv jane konstatuar gabime aritmetike eshte bere korrigjimi I tyre bazuar ne dokumentet e tenderit , pika 3.2. **Korrigjimi i gabimeve dhe pjesët e hequra,nen paragrafi me nr 3.2.3 ku percaktohet shprehimisht se "...nëse ka mospërputhje ndërmjet çmimit njësi dhe vlerës së përgjithshme që merret nga shumëzimi i çmimit njësi dhe sasisë, atëherë do të mbizotërojë çmimi njësi, dhe rrjedhimisht duhet të korrigjohet shumat në total, nëse ka një gabim në një shumë total, që korrespondon me mbledhjen ose zbritjen e nëntotaleve, atëherë do të mbizotërojë nëntotali dhe totali duhet të korrigjohet. Shumat e korrigjuara në këtë mënyrë janë të detyrueshme për ofertuesin. Nëse ofertuesi nuk i pranon ato, atëherë oferta e tij do të refuzohet *Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumat absolute të të gjitha korrigjimeve janë më të larta ose më të ulëta se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar.* "**

Se pari : Jane bere gabime gjate shumezimit te sasise me cmimin per njesi ne shumicen e zerave.

Mbas korrigjimit rezultoi se ne Zerin 1 "Punime dheu "vlera totale eshte 307.660 lek dhe jo 307.561 sic eshte shenuar

Ne zerin 2 Punime prishje vlere totale eshte 97208 lek dhe jo 97,202.49

Ne zerin 3 Punime Murature vlere totale eshte 2513677 dhe jo 2513337.75

Ne zerin 4 Punime betoni dhe betonarme vlere totale eshte 2073825.8 dhe jo 2073779.86

Ne zerin 5 Punime hekuri vlere totale eshte 3130174.8 dhe jo 3130179.28 Ne

zerin 6 Punime hidroizolimi vlere totale eshte 47040 dhe jo 47037.76

Ne zerin 7 Punime shtresash vlere totale eshte 15456057.8 dhe jo 15456149.63

Ne zerin 8 Punime suvatimi dhe tavani vlere totale eshte 2282204 dhe jo 2282387.8

Ne zerin 9 Punime veshje vlere totale eshte 3131007.8 dhe jo 3131166.19

Ne zerin 10 Punime dyer dritare vlere totale eshte 4761970.29 dhe jo 4761972.5

Ne zerin 11 PUnime bojatisje +Patinimi vlere totale eshte 8109816 dhe jo 8110248.3 sic eshte shenuar.

Ne zerin 12 Punime te ndryshme vlere totale eshte 1530486.3 dhe jo 1530508.98

Mbas mbledhjes te vlerave te korrigjuara rezultoi se SHUMA I eshte 43.441.130 dhe jo 43.441.529 sic eshte shenuar.

Edhe ne vazhdim te preventivit jane bere gabime te se njejtës natyre .Mbas mbledhjes te vlerave te korrigjuara rezultoi se

SHUMA III eshte 14136054 dhe jo 14144066.54

SHUMA V eshte 8446185.4 dhe jo 8444353.158

SHUMA VI eshte 13868704 dhe jo 13868752.16

Se dyti Nga mbledhja e nentotaleve te korrigjuara si me sipër rezultoi se vlere e ofertes pa tvsh eshte 108.443.650 lek dhe jo 101.930.749,9 sic eshte shenuar ne preventiv dhe ne formularin e cmimeve .

Llogaritja e vleres pa tvsh eshte bere si me poshte:

A-SHUMA (I+III+V)+ fondin rezerve 5% =69324537 lek,pa tvsh

B-SHUMA (II)=2695000 lek,pa tvsh

C-SHUMA (IV+VI)+fondin rezerve 5% =36424113 lek,pa tvsh

Vlere e ofertes pa tvsh =A+B+C=108.443.650 lek

Duke qene se shumet absolute te te gjitha korrigjimeve jane me te larta 2% te vleres te ofertes atehere kjo oferte eshte e pavlefshme, bazuar ne Kreun V,pika 4\ç,te VKM Nr 1 dt 10.01.2007 ku percaktohet se : *”Ofertat me gabime aritmetike refuzohen, kur shumet absolute të të gjitha korrigjimeve janë më të larta ose më të ulëta se 2% e vlerës së ofertës ekonomike të ofruar. ”*

2.Bashkimi i operatoreve ekonomike, Shoqeria “Beladi” sh.p.k NIPTJ62903254C dhe Shoqeria “Beqari” sh.p.k NIPT J64103603J per arsye se:

1.Ne licencen e paraqitur nga Shoqeria Beladi sh.p.k kategoria N.S 12 ka klasifikimin A nderkohe qe ne kriteret e vendosura ne dokumentet e tenderit, shtojca 10, kriteret e vecanta te kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 2, eshte kerkuar klasifikimi C.

Ne kontraten e bashkepunimit midis shoqerise Beladi sh.p.k dhe Beqarish.p.k rezulton se shoqeria Beldadi shpk do te kryeje punimet qe kane te bejne me “Impiantet teknologjike termike dhe te kondicionimit” ne nje vlere mbi 20.000.000 lek, pra tejkalon vleren e kategorise per te cilen eshte licencuar shoqeria Beladi sh.p.k .

2-Nuk ploteson kriterin per punet e ngjashme.

Konkretisht:

Shoqeria Beladi sh.p.k nuk ka paraqitur situacion te punimeve te kryera

Shoqeria Beqari sh.p.k nuk ploteson vleren e kerkuar ne perputhje me perqindjen qe ka marre persiper te kryeje .Gjithashtu kontrata qe ka paraqitur nuk eshte e ngjashme me objektin e prokurimit.

3.Jane paraqitur deshmi kualifikimi te sigurimit teknik per 16 persona dhe jo per 20 persona sic kerkohet ne dokumentet e tenderit, kriteret e vecanta te kualifikimit, **kapaciteti teknik,pika 3.b** ku percaktohet shprehimisht se *“Operatoret ekonomike pjesemarrres duhet te kene te punesuar te pakten 20 persona te pajisur me deshmi kualifikimi te sigurimit teknik per punonjesit qe jane perdorues te pajisjeve elektrike, nga Inspektoriati Qendror Teknik.”*

4.Ka mangesi ne dokumentacionin e kerkuar ne dokumentet e tenderit, **kriteret e vecanta te kualifikimit, kapaciteti teknik, pika 5.**

Mangesite jane si me poshte:

-Lidhur me materialet “Pllaka”, “Lesh guri” nuk ka skeda teknike. -Per materialet Dyer xham dhe Vetrata nuk ka skede teknike

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Shoqerine“Konstruksion 93”sh.p.k si perfaqesuese e bashkimit te operatoreve ekonomike “Konstruksion 93”sh.p.k dhe “Xhengo” sh.p.k se oferta e paraqitur me një vlerë të përgjithshme prej **126.121.246,9(njeqind e njezet e gjashte milion e njeqind e njezet e nje mije e dyqind e dyzet e gjashte presje nente) lek, pa tvsh,** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Bashkise Korçe** kopjen e nënshkruar të formularit të kontratës dhe të sigurimit të kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 ditëve nga dita e publikimit të së këtij njoftimi, por jo me vone se 5 dite nga kerkesa e per lidhjen e kontrates.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, klasifikimi i perfundimtar do te behet, siç parashikohet në nenin 58 të ligjit për prokurimet publike Nr 9643 date 20.11.2006.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 14.09.2015

Ankesa: JO

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike *Date 20/07/2015 [Numri]*

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë keta ofertues me ofertat ekonomike si vijon:

1. Operatori “**Agimi B**” sh.p.k. me vlerë të ofertës **6.500.980** (gjashte milion e peseqind mije e nenteqin e tetedhjetë) Lekë pa TVSH.
2. Operatori “**Alen Co**” sh.p.k. me vlerë të ofertës **6.684.660** (gjashte milion e gjashteqind e tetedhjetë e kater mije e gjashteqind e gjashtedhjetë) Lekë pa TVSH.
3. Operatori “**Gentian Horieti**” sh.p.k. me vlerë të ofertës **6.278.530** (gjashte milion e dyqind e shtatedhjetë e tete mijë e peseqind e tridhjetë) Lekë pa TVSH.
4. Operatori “**Power Industries**” sh.p.k. me vlerë **3.222.800** (tre milion e dyqind e njezet e dy mije e teteqind) Leke pa TVSH.

